



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 201600849/7

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2016

**Lënda:** *Rekomandohet "Fillimi i hetimit ndaj punonjësve të Shtëpisë së Fëmijës Parashkollor 3- 6 vjeç Shkodër, znj. H. H., me detyrë kujdestare dhe znj. L. L., me detyrën e edukatores në këtë institucion", për veprën penale "Keqtrajtimi i të miturit", parashikuar nga neni 124/b i Kodit Penal.*

**Drejtuar:** Drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor  
Z. Granit SHAHU

**SHKODËR**

**Për dijeni:** Prokurorit të Përgjithshëm  
Z. Adriatik LLALLA

**TIRANË**

*I nderuar Z.SHAHU,*

Në përmbushje të detyrave kushtetuese dhe ligjore në mbrojtje të të drejtave njerëzore të fëmijëve, Institucioni i Avokatit të Popullit ka hartuar planin e inspektimeve dhe po vijon punën për inspektimet në Qendrat publike të përkujdesit rezidencial të të miturve në të gjithë vendin.

Në këtë kuadër, në datën 26.05.2016, në Shtëpinë e Fëmijës Parashkollor 3-6 vjeç Shkodër, një grup ekspertësh të institucionit të Avokatit të Popullit, kreu një inspektim mbi kushtet e trajtimit të fëmijëve nga ana e stafit përgjegjës në këtë institucion.

Ky inspektim u krye në mbështetje të Ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, ku parashikohet ndër të tjera se: *"Avokati i Popullit ose persona të autorizuar prej tij kanë të drejtë të hyjnë në çdo kohë, pa kufizim apo autorizim paraprak, por duke vënë në dijeni titullarin e institucionit, në të gjitha institucionet e administratës publike, në azile dhe veçanërisht në shtëpi fëmije, si dhe në çdo vend tjetër ku ka të dhëna dhe çmon se ekziston mundësia e shkeljes së të drejtave dhe lirive të njeriut"*.

*"Hyrja në të gjitha mjediset e mësipërme mund të bëhet si për të hetuar një ankesë, një kërkesë ose njoftim të caktuar, ashtu edhe me nismën e Avokatit të Popullit për qëllime inspektimi apo studimi. Avokati i Popullit në këto raste mund të marrë takim, të bisedojë në mënyrë konfidenciale e pa praninë e personave zyrtarë me cilindo person që ndodhet apo mbahet në këto mjedise"*.

Nga ana e grupit inspektues fillimisht u mor takim me drejtoreshën e këtij institucioni të cilës ju bë me dije objekti i këtij inspektimi që ishin kushtet dhe trajtimi i fëmijëve nga ana e stafit përgjegjës në këtë institucion. Nga ana e saj drejtoresha sqaroi se, në momentin e vizitës sonë, 10 fëmijët e grup moshës 3-6 vjeç ndodheshin në kopsht, ndërsa 8 fëmijët 6-8 vjeç në shkollën pranë shtëpisë së fëmijës.

Menjëherë grupi i ekspertëve, shkoi në kopshtin dhe shkollën 9-vjecare të cilat gjendeshin në të njëjtën godinë dhe shumë pranë Shtëpisë së Fëmijës. Kopshti i fëmijëve, përbëhej nga dy dhoma, (klasa shkolle), i cili frekuentohej edhe nga fëmijë të tjerë të cilët nuk ishin pjesë e shtëpisë së fëmijës. Pasi informuam drejtoreshën e kopshtit, për qëllimin e vizitës sonë grupi i ekspertëve mori menjëherë kontakt me fëmijët. Në ambientet e njërës klasë u kërkuan në mënyrë rastësore 5 fëmijë të shtëpisë së fëmijës, me të cilët fillimisht u zhvillua një bisedës e lirë, në mënyrë që fëmijët të akomodoheshin sa më shumë të ishte e mundur me grupin e ekspertëve. Më pas intervistat vazhduan në mënyrë individuale. E njëjta procedurë u ndoq edhe me 5 fëmijët e tjerë të këtij kopshti. Nga bisedat konfidenciale me këta fëmijë, të moshës 4-5 vjeç u konfirmuan të dhënat që grupi i ekspertëve kishte marrë në shtëpinë e fëmijës gjatë inspektimit të datës 18 Prill 2016. Thuajse të gjithë fëmijët e kësaj shtëpie treguan se në rast kur bënin gabime, dënimi që ata merrnin ishte duke i vendosur me fytyrë nga muri, me një këmbë të ngritur. Përveç kësaj, nga fëmijë pak më të rritur, të moshës 6 vjeç u përmend edhe një formë tjetër dënimi që ishte mbyllja te "Dhoma e miut". Pasi përfunduam intervistimin e fëmijëve në kopshtin pranë shtëpisë, u interesuam për fëmijët pak më të rritur, nxënës të klasës së parë, të cilët kishin mbaruar mësimin, ndaj dhe intervistimi i tyre u kërkua që të kryhej në një ambient të përbashkët të shtëpisë.

Nga bisedat me fëmijët na u ri konfirmuan të dy mënyrat e dënimit të fëmijëve që bënin gabime. Sipas tyre, edukatorët për rastet kur ndonjë prej tyre bënte "sherre", i dënonin duke qëndruar me një këmbë. Ajo që rezultoi më

shqetësuese, ishte fakti që si kujdestare Hajrie Hoxha, të cilës fëmijët i referoheshin si “nëna Lija” dhe edukatore Laura Ljarja, për raste kur fëmijët si M. K, A.G, bënin “sherre” i mbyllnin tek një dhomë që ndodhej poshtë shkallëve në katin e parë, vendndodhjen e së cilës fëmijët e treguan vetë. Ndërsa periudha kur këta fëmijë janë mbyllur në këtë dhomë, si dhe kohë qëndrimi i tyre brenda saj ishte e vështirë të përcaktohej nga ata. Kjo dhomë kishte një derë metalike, pa dritare, e pa suvatuar dhe një hapësirë 1x1m<sup>2</sup> e cila përdorej si magazinë ku mbaheshin materiale të ndryshme. Kjo dhomë e ashtuquajtur “dhoma e miut”, quhej kështu për faktin se fëmijët në disa raste kishin parë minj aty brenda.

Avokati i Popullit si një institucion që mbron të drejtat dhe interesat e ligjshme të qytetarëve kur ato cenohen nga veprimet apo mosveprimet e parregullta të administratës publike, për rastin konkret ka pasur parasysh legjisllacionin shqiptar dhe aktet ndërkombëtare në mbrojtje të të drejtave të fëmijëve.

Kështu në nenin 54 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë thuhet: *“1.Fëmijët, të rinjtë, gratë shtatzëna dhe nënat e reja kanë të drejtën e një mbrojtje të veçantë nga shteti. 2. Fëmijët e lindur jashtë martesë kanë të drejta të barabarta me të lindurit nga martesë.3. Çdo fëmijë ka të drejtë të jetë i mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi, shfrytëzimi dhe përdorimi për punë, e veçanërisht nën moshën minimale për punën e fëmijëve, që mund të dëmtojnë shëndetin, moralin ose të rrezikojnë jetën e zhvillimin e tij normal”.*

Të drejta të fëmijëve janë të garantuara dhe nga Konventat Ndërkombëtare të ratifikuara nga Qeveria shqiptare, si Konventa e Kombeve të Bashkuara “Mbi të drejtat e fëmijës” datë 20 Nëntor 1989, duke kujtuar se *“në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, Kombet e Bashkuara kanë shpallur që mosha e fëmijërisë ka të drejtë për një përkujdesje dhe përkrahje të veçantë”.*

Shërbimet Sociale për fëmijët kanë për qëllim mbrojtjen dhe sistemimin në Institucione të Përkujdesit Shoqëror të fëmijëve në nevojë, si fëmijët jetimë socialë dhe biologjikë deri në moshën 18 vjeç, çka do të thotë se këta fëmijë janë të privuar nga kujdesi prindëror, dhe për rrjedhojë është shteti ai që ka marrë dorëzaninë e tyre.

Është detyra e Qendrave Rezidenciale për fëmijët e rritur jashtë familjes të gjejnë një mjedis të sigurt, përkujdes cilësor, që ju mundëson atyre duke lënë institucionin ose të gjejnë rrugën në shoqëri, si qytetarë të përgjegjshëm dhe plotësisht të integruar në jetën e komunitetit, ose mund të kthehen në familjet e tyre biologjike, ose në familje që do të mundësojnë rritjen e tyre.

Nga hetimi administrativ i kryer rezultoi se nga punonjësit e Shtëpisë së Fëmijëve Parashkollor 3-6 vjeç Shkodër, kujdestarja Hajrie Hoxha dhe edukatore Laura Ljarja, persona të cilët kanë për detyrë të kujdesen dhe t’ju shërbejnë fëmijëve, kanë kryer veprime aktive që konsistojnë në keqtrajtimin fizik duke i vendosur fëmijët me një këmbë, apo keqtrajtim psikologjik duke i mbyllur tek “Dhoma e miut” të cilat shkaktojnë dëmtime të shëndetit mendor dhe social të fëmijëve të mitur të cilat kanë sjellë si pasojë trajtime degraduese

e frikësuese dhe përbëjnë dhunë psikologjike, duke shkelur kështu nenet 19 dhe 20 të Konventës mbi të Drejtat e Fëmijëve<sup>1</sup>, pikën a), të nenit 21, të ligjit nr. 10347, datë 04.11.2010 “Për mbrojtjen e Fëmijës”. Këto veprime bien ndesh dhe me pikën 10, të Standardeve, të sanksionuara në VKM nr. 659, datë 17.10.2005 “Për standardet e shërbimeve të përkujdesit shoqëror, për fëmijët në institucionet rezidenciale”.

Veprimet e mësipërme janë të kundërligjshme dhe përbëjnë dhe vepër penale, e cila parashikohet në nenin 124/b të Kodit Penal “Keqtrajtimi i të miturit”. Objekti i veprës penale janë marrëdhëniet juridike të vendosura nga shteti për të siguruar paprekshmërinë e të miturit nga çdo lloj kërcënimi fizik apo psikologjik, të mbrojtura posaçërisht nga legjislacioni penal nga veprimet kriminale.

Institucioni i Avokatit të Popullit duke respektuar dispozitat përkatëse të parashikuara në ligjin e tij funksional në kuadër të hetimit të pavarur administrativ udhëhiqet nga objektiviteti dhe paanshmëria. Nga ekspertët e institucionit për këto raste realizohet me korrektësi kryerja e veprimeve të mundshme me gjithë vështirësitë e paraqitura sidomos në trajtimin e problemeve me të miturit.

Për rrjedhojë duke kërkuar fillimin e hetimit mbajmë në konsideratë mundësinë e kryerjes nga organi procedues dhe të veprimeve të tjera tekniko shkencore, çka nuk mund të realizohen nga Institucioni i Avokatit të Popullit. Një vlerë e shtuar që duhet theksuar është dhe fakti i një bashkëpunimi korrekt institucional mes institucionit të Avokatit të Popullit dhe Prokurorisë me qëllim realizimin e mbrojtjes të të drejtave dhe lirive të qytetarëve.

Për sa sipër dhe bazuar në nenin 63, pika 3 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë ku thuhet : *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave të njeriut nga administrata publike”* dhe në bazë të nenit 21 gërma d) të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar ku thuhet: *“Avokati i Popullit, pas përfundimit të hetimit, për shkelje të rënda, të vëna re, i propozon çdo organi, si dhe Kuvendit, shkarkimin e funksionarëve që janë kompetencë e tyre;*

## **REKOMANDOJMË**

---

<sup>1</sup> Neni 19. Shtetet Palë marrin të gjitha masat legjislative, administrative, shoqërore dhe edukative për mbrojtjen e fëmijës nga çdo formë e dhunës fizike ose mendore, fyerja ose keqtrajtimi, braktisja apo mospërfillja, nëpërkëmbja ose shfrytëzimi, përfshirë abuzimin seksual, për sa kohë që ai është nën ruajtjen e prindërve të tij ose të njërit prej tyre, të përfaqësuesit ose përfaqësuesve të tij ligjorë ose të çdo personi tjetër të cilit i është besuar. 2. Këto masa mbrojtjeje përfshijnë, kur është e përshtatshme, procedura të efektshme për hartimin e programeve shoqërore për përkrahjen e nevojshme të fëmijës dhe atyre që kujdesen për të, si dhe për forma të tjera parandalimi dhe identifikimi, raportimi, referimi, hetimi, trajtimi dhe ndjekjeje të rasteve të keqtrajtimit të fëmijës, të përshkruara më lart, duke përfshirë, në se duhet, procedurat e ndërhyrjes gjyqësore.

Neni 20 1. Një fëmije, të cilit i mohohet në mënyrë të përkohshme ose të përhershme mjedisi i tij familjar, ose kur nuk është në interesin e tij më të lartë të qëndrojë në këtë mjedis, ka të drejtë për një mbrojtje dhe një ndihmë të posaçme nga shteti. 2. Shtetet Palë sigurojnë për këtë fëmijë një përkujdesje alternative, në përputhje me legjislacionin e tyre të brendshëm. 3. Kjo përkujdesje alternative mund të ketë, inter alia, formën e vendosjes në një familje, të “Kafalasë” sipas të drejtës islamike, të birësisimit ose, në rast nevojë, të vendosjes në një qendër të përshtatshme të kujdesit për fëmijët. Në gjetjen e këtyre zgjidhjeve, duhet të mbahen mirë parasysh dëshira për vazhdimësinë në edukimin e fëmijës, si dhe origjina e tij etnike, fetare, kulturore dhe gjuhësore.

“Fillimin e hetimit ndaj punonjëseve të Shtëpisë së Fëmijës Parashkollor 3- 6 vjeç Shkodër, znj. Hajrie Hoxha me detyrë kujdestare dhe znj. Laura Ljarja, me detyrën e edukatores në këtë institucion, për veprën penale “Keqtrajtimi i të miturit”, parashikuar nga neni 124/b i Kodit Penal”.

Mbi qëndrimin që do të mbani ndaj rekomandimit, në përputhje me nenin 22 të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, lutemi të na vini në dijeni brenda afatit 30 ditor.

Bashkëlidhur ju dërgojmë dokumentet e mëposhtme:

1. Fotokopje të listës së fëmijëve sipas moshave në Shtëpinë e Fëmijës Parashkollor 3-6 vjeç Shkodër.
2. Fotokopje të listës me të dhënat e punonjësve për Shtëpinë e Fëmijës Parashkollor 3-6 vjeç Shkodër.
3. Foto të dhomës poshtë shkallëve, në katin e parë të ndërtesës së Shtëpisë së Fëmijës Parashkollor 3-6 vjeç Shkodër.

*Duke besuar në mirëkuptimin Tuaj,*

**AVOKATI I POPULLIT**

**Igli TOTOZANI**